

**Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm,** gjyqtari Burim Shala në çështjen kontestimore të paditësit XH.M. nga ..., komuna e Kamenicës, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës - Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson Shefqet Rexha, si përfaqësues i Komunës, për shkak të të ardhurave personale, në seancën për shqyrtim kryesor më datën 02.09.2015 mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. Refuzohet si e pa bazuar** kërkesë padia e paditësit XH.M. nga ..., me të cilën ka kërkuar që të **detyrohet** e paditura Komuna e Kamenicës – Drejtoria e Arsimit, t’ia paguaj dy paga mujore në emër të përcjelljes në pension dhe dy paga jubilarë në vlerë prej 1.685.00 Euro me kamat ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

**II. Detyrohet paditësi** të paguaj shumën në vlerë prej 10 Euro, në emër të taksës gjyqësore për vendim, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Paditësi XH.M. nga .... në këtë gjykatë ka paraqitur padi më datë 05.06.2014, kundër të paditurës, Komunës së Kamenicës - Drejtorisë së Arsimit në Kamenicë, për shkak të dy pagave mujore për shpërblim jubilar, dy pagave mujore për përcjellje në pension.

Gjatë seancës për shqyrtim kryesor paditësi XH.M. ka mbetur në tërësi pranë padisë, ka theksuar se prej vitit 1969 ka punuar si profesor i Matematikës te e paditura ndërsa me dt.05.08.2013 ka dalur në pension, ngase ka arritur moshën 65 vjeçare, ndërsa e paditura nuk mi ka paguar dy paga jubilar dhe dy paga përcjellëse për pension dhe ato më takojnë sipas kontratës kolektive, ka propozuar gjykatës që si prova të administrohen vendimi për pensionimin e punëtorit nr.236716 prej dt.19.08.2013, kontrata e punës nr.668/87 prej dt.11.10.2012, përgjigja në kërkesë nr.629 prej dt.24.09.2013, e pas administrimit të këtyre provave, i ka propozuar gjykatës që kërkesë padia të aprovohet si e bazuar, po ashtu edhe në fjalën përfundimtare, i ka propozuar gjykatës që kërkesë padia të aprovohet si e bazuar.

I autorizuari i të paditurës Shefqet Rexha, ka mbetur në tërësi pranë përgjegjës në padi.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike ka bërë zhvillimin e provave, ka lexuar vendimi për pensionimin e punëtorit nr.236716 prej dt.19.08.2013, kontrata e punës nr.668/87 prej dt.11.10.2012, përgjigja në kërkesë nr.629 prej dt.24.09.2013, e pas zhvillimit të këtyre provave një nga një dhe të tërëve bashkërisht në kuptim të nenit 7 dhe 8 të LPK-së, dhe ka ardhur në përfundim se kërkesë-padia e paditësit është e pa bazuar.

Mes palëve nuk është kontestuese fakti se paditësi ka punuar tek e paditura dhe ka dalur në pension prej saj, kjo u vërtetua nga vendimi për pension, kontrata e punës, përgjigja në

kërkesë, pra kontestues është paraqitur fakti se nuk ka bazë ligjore që paditësit ti paguhen këto paga pas daljes në pension.

Kontrata e përgjithshme kolektive e lidhur në mesë të BSPK-së, në njërën anë dhe MPMS dhe OEK në anën tjetër ka pas vlefshmëri, gjegjësisht ka qenë në fuqi vetëm për tri vite dhe me kalimin e atyre tri vite ka pushuar së vlejtori, gjegjësisht nuk ka qenë në fuqi, sipas dispozitave të ligjit të aplikueshëm të punës.

Pra, çështja e pagimit të pagave përcjellëse dhe pagave jubilarë si dhe e regresit, pas daljes në pension si shpërblim për punëtorin është paraparë vetëm në kontratën kolektive ndërkaq nuk është paraparë në ndonjë dispozitë ligjore tjetër, e kontrata e përgjithshme kolektive nuk ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi ka dalë në pension në vitin 2013.

Prandaj, gjykata duke marrë parasysh faktin se kontrata kolektive, ka hyrë në fuqi me 1 janar 2005, me afat të vlefshmërisë 3 vjeçare, sipas ligjit të aplikueshëm të punës, përkatësisht deri me 01.01.2008, dhe nuk është vazhduar më përkatësisht nuk është lidhur kontratë e re, pra kur paditësi ka daluar në pension, kontrata e përgjithshme kolektive nuk ka qenë në fuqi, dhe nuk është nënshkruar kontratë e përgjithshme kolektive tjetër, ndërkaq kontrata e përgjithshme kolektive e cila ishte në fuqi kishte pushuar së vlejtori me datë 01.01.2008, mbi pesë vite para se paditësi të dilte në pension, prandaj, edhe gjykata në mungesë të bazës ligjore kërkesë-padinë e ka refuzuar si të pa bazuar.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 452 të LPK-së, vetëm sa i përket shpenzimeve gjyqësore për vendim ndërkaq shpenzime të specifikuara nga i padituri nuk ka pasur.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË KAMENICË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**C.nr.85/14, më dt.02.09.2015**

**Gj y q t a r i,**  
Burim Shala d.v.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.